

RELACION TEKNIK

Mbi procedurën e tenderimit të objektit “Ndërtim Rruga Porto Romano loti 3”

Në vijim të korespondencës me shqyrtimin e ankesave nga ofertesës pjesmarrës në tender dhe në përgjigje të kërkesës së bërë nga Drejtoria Juridike sqarojmë KVO dhe nëpërmjet saj të gjithë ofertuesit në tender për:

Projekti i Rrugës Porto Romano loti 3 është projekt i hartuar në vitin 2009 nga studio projektuese “AF-Infra Trans Projekt” dhe miratuar me Vendimin e KT të ARRSH datë 29.06.2009. Projekti shtrihet në zonën ish- kënetore të Durrësit dhe shërben kryesisht si rrugë për zhvillimet dhe planifikimet në fushën e industrisë së naftës. Projekti shtrihet në një zonë ku momentalisht ka mjaft probleme mjedisore me ndotjen dhe depozitimin e plehrave të cilat kanë kontaminuar të gjithë zonën dhe përbejnë shqëtesim real për banorët dhe biznesin.

Autoriteti Kontraktor ka vendosur të publikojë në dokumentat e tenderit preventivin e plotë (pa çmime) për punimet e mbetura që aksi të kompletohet, siç është dorëzuar nga projektuesi. Në kushtet e shkurtimeve buxhetore për shkak të situatave të krijuara, AK ka planifikuar të investojë pjesën e mbetur të punimeve, duke konsideruar ndërtimin e trupit të rrugës për të gjithë aksin, por, i kushtëzuar të reduktojë një pjesë të shtresave asfaltike dhe sinjalisikën rrugore (si punime që realizohen në fund të programit të punimeve). **Pikërisht, për të mos krijuar konfuzion tek ofertuesit që projekti nuk përputhej me preventivin, në dokumentat e tenderit (vizatime, specifikime teknike, preventivë) janë lënë edhe zërat e punimeve që pritet të realizohen me një investim të mëvonshëm sipas projektit, por që ofertuesëve nuk i është kërkuar të japin ofertën e tyre për arsyet e sipërpermendura (duke i shënuar qartazi me tekstin “*NUK APLIKOHET*”)**

AK brënda mundësive që do ketë në të ardhmen me sigurimin e financimeve do të bëjë të mundur vazhdimin e përfundimit të zërave të punimeve të mbetura për përfundimin e plotë të projektit. Këto punime nuk janë detyrë apo detyrim për ofertuesit në tender. Atyre i kërkohet saktë për çfarë do japin ofertat e tyre ekonomike dhe për të qënë dhe më të qartë ju është dhënë projekti me specifikimet teknike të plota (edhe për zërat e punimeve që nuk do aplikohen në këtë procedurë).